



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

LËNDA: GJUHË FRËNGE

PROVIM I DETYRUAR (niveli B1)

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Viti shkollor 2014 – 2015

Tiranë

Janar, 2015

Përmbajtja e Programit

1. Synimet e Programit
2. Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit
3. Aftësitë dhe njohjet që duhet të zotërojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës me detyrim në gjuhën frënge.
4. Struktura e Provimit të Maturës Shtetërore me Zgjedhje, Gjuha Frënge
5. Objektivat e vlerësimit të ndara saktësisht sipas tre niveleve.
6. Tipe ushtrimesh që nxënësi duhet të punojë për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës me detyrim në gjuhën frënge.

1. Synimet e Programit

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës frënge, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale.

Programi orientues për përgatitjen dhe realizimin e provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge si provim i detyruar, është realizuar si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë, si në aspektin tematik ashtu edhe në aspektin gjuhësor (gramatikor, leksikor) dhe funksional.

Programi Orientues është hartuar duke pasur parasysh nevojat e nxënësve, zhvillimet e tyre individuale duke u dhënë mundësi për sukses në atë çka i pret.

Ky program synon:

- *Të ndihmojë nxënësin maturan në përgatitjen e tij për provimin e gjuhës frënge si provim i detyruar në nivelin gjuhësor B1, bazuar në nivelet gjuhësore të përcaktuara në Kornizën Evropiane të Gjuhëve.*
- *Të ndihmojë mësuesin e lëndës në punën e tij për zbatimin e programit dhe për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve për mënyrën se si të mbështeten në këtë program dhe çfarë duhet të dinë ata për të realizuar me sukses këtë provim përmbyllës të dijeve të tyre në këtë lëndë.*
- *Orientimin e vlerësimit që do të përfshijë 2 aftësi kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) dhe dy konceptet bazë, që janë: 'të lexuarit dhe të kuptuarit' dhe 'të shprehurit me shkrim'.*
- *Të japë orientime për specialistët që merren me hartimin e testeve të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge si provim i detyruar.*

2. Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, ku nxënësi në provim do të përballlet me situata të reja ose me pjesë të reja leximi por tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

- *Kur flitet për tematikën kryesore në program nxënësit duhet që të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program (l'école et l'éducation, le sport et les loisirs , l'environnement, les voyages touristiques et les échanges culturelles, la mode, la musique etc)
etc.)*

-Përsa i përket përdorimit të gjuhës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore dhe leksikore që ata kanë trajtuar gjatë viteve të shkollës së mesme. (les temps de l'indicatif, le conditionnel présent, le conditionnel passé, la phrase *passive*, le subjonctif présent, le discours rapporté, les pronoms, les adjectifs, les articles, les adverbes etc.)

Leksiku është i lidhur me tematikën e trajtuar si: (les loisirs, les fetes, les vacances, les voyages, la technologie, la mode etc) duke dalë nga konteksti i mësimave ku këto probleme trajtohen. Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të zgjidhjes së ushtrimeve, duke i trajtuar këto ushtrime në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa, e herë me tipe ushtrimesh të hapura, ku më të spikaturat janë: (remplacez avec les mots..., transformez la phrase, trouvez le synonyme /l'antonyme etc).

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës por duke ruajtur formatet dhe shprehjet që jepen në tekstet mësimore. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto nocione gjuhësore:

- *Demander et donner des explications, des informations sur des questions liées à leur centre d'intérêt*
- *Donner et demander un avis, une opinion, p.ex.: je pense que, je crois que, il me semble que?*
- *Raconter un évènement, exprimer la durée d'une action, p.ex.: Depuis ..., ça fait... il y a ... etc.*
- *Exprimer leur intérêt*
- *Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement.*
- *Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements au passé, p.ex.: d'habitude*
- *Suggerer et prendre une décision*
- *Accepter/refuser une invitation*
- *Parler de leurs centres d'intérêt, de leur mode de vie*
- *Présenter les raisons d'un choix*
- *Exprimer un souhait, un désir*
- *Demander des informations*
- *Raconter une expérience passée*
- *Décrire les circonstances d'un événement*
- *Apporter des précisions d'ordre temporel*
- *Faire une réclamation*
- *Comparer des comportements*
- *Argumenter de manière simple*
- *Donner des informations pratiques*

- *Caractériser des personnes et des comportements*
- *Développer une hypothèse*
- *Formuler un regret, un reproche*
- *Parler de leurs aspirations*
- *Faire des recommandations, conseiller :*
- *Construire un discours en articulant clairement vos idées*
- *Justifier une opinion ou une action.*

Përsa i përket të shkruarit mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit e tij që të dinë të organizojnë forma të ndryshme të të shkruarit si:

- *Ecrivez une email à un ami pour raconter un voyage ,un spectacle,une experience vecue*
- *Ecrivez le contenu d'un livre ou d'un film*
- *Ecrivez une lettre de recomandation*
- *Ecrivez une lettre personnelle de caractere narratif ou descriptif*
- *Ecrivez une lettre à des amis pour leur donner des nouvelles ou pour raconter un evenement*
- *Ecrivez le resumé d'un texte.*

3. Aftësitë dhe njohjet që duhet të zotërojë nxënësi maturant për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës me detyrim në gjuhën Frënge në Nivelin B1.

Nxënësi që do t'i ushtrohet provimit të Maturës me Detyrim në gjuhën Frënge duhet të demonstrojë **aftësitë dhe njohjet** e tij për çka ka marrë dhe përfituar nga të nxënësit në këtë lëndë gjatë viteve të shkollës së mesme. Përshkrimin e kompetencave dhe njohurive po i paraqesim në gjuhën Frënge pasi nxënësi është njohur me to në portofolin e gjuhëve të huaja ku jepet përshkrimi për çdo nivel gjuhësor.

Në **Lexim dhe te shprehur (Compréhension écrite)** nxënësi duhet të arrijë këto kompetenca dhe njohuri:

Les élèves du niveau B1 doivent comprendre l'essentiel d'un texte portant sur des sujets liés à leur centre d'intérêt

- *Ils doivent saisir l'essentiel des textes courts tels qu'un résumé sur l'actualité, comprendre des informations générales de la vie quotidienne tels que des lettres, de petits documents officiels, des dépliants simples.*
- *Ils doivent comprendre des articles ou des interviews dans des journaux et des magazines dans lesquels il y a une prise de position sur un thème particulier.*
- *Ils doivent comprendre l'information essentielle d'un texte et les arguments donnés.*

- Ils doivent comprendre et décrire des événements, en exprimant leurs sentiments, vœux et souhaits.
- Ils peuvent comprendre et décrire des instructions sur l'utilisation d'équipements quotidiens

Në **Shkrim (à l'écrit)** nxënësi duhet të arrijë këto kompetenca dhe njohuri:

Les élèves du niveau B1 peuvent :

Ecrire des textes simples sur des sujets liés à leur centre d'intérêt et exprimer leur point de vue et leur opinion

- *Décrire dans une lettre leurs expériences (un voyage, un spectacle à l'école, un concours) pour le journal de l'école*
- *Décrire un événement imprévu en exprimant le bonheur, la tristesse, l'intérêt ou le regret.*
- *Décrire le contenu d'une livre ou d'un film, commenter un concert ou un spectacle.*

Në **frengjisht** nxënësi duhet të arrijë këto kompetenca dhe njohuri:

a) Functions/ notions

- *Décrire le lieu*
- *Décrire des expériences et des événements passés*
- *Décrire les émotions, sentiments et comportements*
- *Exprimer l'opinion*
- *Exprimer les arguments pour ou contre*
- *Parler d'un film ou d'un livre*

b) les modes et les temps verbaux composés

- *le présent des verbes du premier, deuxième groupe et des verbes irréguliers,*
- *le plus-qu-parfait / l'imparfait/ le passé composé,*
- *le futur / le futur antérieur,*
- *la concordance des temps de l'indicatif,*
- *le conditionnel présent, le conditionnel passé ,*
- *le subjonctif présent,*
- *l'infinitif présent,*
- *le gérondif,*
- *l'impératif*
- *l'expression de la cause et de la conséquence,*
- *l'expression du but,*
- *l'expression de la durée*
- *le discours rapporté au présent*
- **les pronoms,**
- *complément d'objet direct,*
- *complément d'objet indirect,*
- *la place des deux pronoms: ex. Je le lui donnerai,*
- *les pronoms relatifs simples*

- les pronoms: y et en,
- les pronoms indéfinis,
- Le comparatif et le superlatif.

Les adjectifs et les pronoms

- l' accord, le genre et la place de l'adjectif,
- l' adjectif et le pronom possessif,
- l'adjectif et le pronom démonstratif,
- l' adjectif et le pronom interrogatif.

4. Struktura e Provimit të Maturës Shtetërore, Gjuha Frënge me detyrim në nivelin B1.

Testi i gjuhës Frënge me detyrim në nivelin gjuhësor B1 do të jetë i ndarë në 3 seksione ku testohen:

- Të kuptuarit e një pjesë letrare ose jo letrare
- Përdorimi i gjuhës që përfshin aspektet më të rëndësishme gramatikore dhe leksikore trajtuar në vitet e shkollës së mesme
- Të shkruarit

Pesha që zë çdo kompetencë në provim	Seksioni 1 <i>Compréhension de l'écrit</i>	Seksioni 2 <i>Grammaire et lexicque</i>	Seksioni 3 <i>Production écrite</i>
Në %	40%	40%	20%
Në pikë	20 pikë	20 pikë	10 pikë
Niveli 1	10 pikë	10 pikë	
Niveli 2	10 pikë	10 pikë	
Niveli 3			10 pikë

Nxënësi me *Nivelin 1, 2, 3*, do të duhet të nënkuptojë që janë pyetje të nivelit të lehtë, mesatar dhe të vështirë.

5. Objektivat e vlerësimit të ndara dhe detajuara saktësisht sipas tre niveleve.

Nr	Linjat	Pikët	Pesha
1	<i>Të Lexuarit dhe të Kuptuarit</i>	<i>20 pikë</i>	<i>40%</i>
	<ul style="list-style-type: none"> • gjetja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë (Niv.1) • reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij (Niv.1) • perifraximi i një fraze ose shprehjeje shkëputur nga 	3 pikë 3 pikë 3 pikë	

	<ul style="list-style-type: none"> teksti (Niv.2) • nxjerrja e një kuptimi të përgjithshëm dhe e moralit të pjesës, ose idesë qendrore shprehur në gjuhë të thjeshtë (Niv.3) • gjetja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë (Niv.2) • plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit (Niv.1) • gjetja e fjalëve referuese (Niv.2) 	<p>2 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p>	
2	<i>Gramatika</i>	<i>10 pikë</i>	<i>20%</i>
	<ul style="list-style-type: none"> • kohët e foljeve (Niv. 1) • shkallët e mbiemrave, (Niv. 1) • përemrat (Niv. 1) • përemrat lidhorë të thjeshtë, (Niv. 1) • parafjalët (Niv. 2) • shprehjet me parafjalë, (Niv. 2) • format pësore, (Niv. 2) • ligjërata e zhdrejtë, (Niveli 3) • shprehjet frazologjike • kushtoret Nivel 1(Niveli 2) 	<p>1 pikë</p>	
3	<i>Fjalori</i>	<i>10 pikë</i>	<i>20%</i>
	<ul style="list-style-type: none"> • sinonimet (Niveli 2) • antonimet (Niveli 1) • formimi I emrave (Niveli 1) • shndërrime fjalish duke ruajtur kuptimin fillestar (Niveli 2) 	<p>2 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>3 pikë</p> <p>2 pikë</p>	
4	<i>Të Shkruarit</i>	<i>10 pikë</i>	<i>20%</i>
	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i temës (Përmbajtja) • Organizimi • Saktësia në gramatikë • Fjalori i përdorur • Respektimi i rregullave të shkrimit (shenjat e pikësimit, strukturat e ndërtimit të frazave dhe fjalive, gërmat kapitale, etj.) 	<p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p> <p>2 pikë</p>	
<i>Totali</i>		<i>50 pikë</i>	<i>100%</i>

6. Tipe ushtrimesh që nxënësi duhet të punojë për të qenë i përgatitur për Provimin e Maturës me detyrim në gjuhën Frënge.

a) Tipet e ushtrimeve që mund të jepen në Reading Comprehension:

- *Vrai ou faux vertet /gabuar*
- *Choix Multiples* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna)
- *Mettre en ordre des paragraphes* (vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve)
- *Compléter les phrases* (plotësimi i kuptimit të një fjalie ose fraze në një tekst të caktuar mbi një temë të caktuar)
- *Réponses ouvertes* (përgjigje të hapura ku nxënësi shpreh mendimin dhe vlerësimin e tij rreth një çështjeje ose pyetjeje të caktuar rreth tekstit)
- Exercices de grammaires (ushtrime gramatike)

b) Në përdorimin e gjuhës:

Tipet e ushtrimeve që do të përdoren në provimin me detyrim në gjuhën Frënge mund të jenë të tipeve si më poshtë:

- *Choix Multiples* (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 ose 5 alternativat e dhëna);
Exemples

L'émission musicale _____ ce journaliste anime sur TV5 est vraiment passionnante.

- A) dont
- B) où
- C) que
- D) qui

- Entourer la forme du verbe qui convient :

On (était- a été) en mars je me souviens encore que, dehors, la neige (tombait – est tombée).

- Mettez les mots dans l'ordre pour former une phrase

1toi/et/tu/-/que/ton/as/ce/étudiant/ ?/avec/numéro/d'

c) Në temën me shkrim, nxënësi duhet të jetë i aftë të prezantohet me punë të tilla si:

- Email formal ose joformal
- Letër formale ose joformale
- Përshkrim
- Ritregim
- Përmbledhje